

VENDIM
Nr.847, datë 6.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PËR OBJEKTET E INVESTIMIT TË FONDIT TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË, PËR VITIN 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e njësive të qeverisjes vendore, bashki/komuna, si autoritete kontraktore që, brenda datës 10 dhjetor 2011, të përfundojnë procedurat e prokurimit për ndërtimin dhe rikonstrukcionin e objekteve të shërbimit parësor, nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2011, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe njoftimi i kontratës së lidhur.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, njësitë e qeverisjes vendore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha